



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:036050

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06495996

**2024:036051**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, gjyqtarin i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve B.K. dhe B. K.1 që të dy nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.141/24, të datës 06.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurve në njërën anë dhe të dëmtuarit F. H. në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1830/23 të datës 30.01.2024, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 15.11.2024 mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** marrëveshja ND.nr.141/24, të datës 06.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurve B. N. K., i lindur me dt....., me nr. personal ..... dhe B. N. K.1, i lindur me dt....., me nr. personal ....., që të dytë me vendbanim në Ferizaj rruga “.....” nr.. në njërën anë dhe të dëmtuarit F. Rr. H. nga Ferizaj, rruga “....”, në anën tjetër.

Hudhet aktakuza Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1830/23 të datës 30.01.2024 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurve B.K. dhe B. K.1, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së .

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1830/23 të datës 30.01.2024, ka akuzuar të pandehurit për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin gjyqësor me dt.04.11.2024, konform nenet 229 të KPPRK-së dhe nenet 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datë 06.11.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja ND.nr.141/24, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenet 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenet 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim në datën 15.11.2024, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenet 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenet 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

### **DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

**2024:036051, me dt. 15.11.2024.**

**Zyrtare ligjore**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

**Kimete Bytyqi**

**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tre/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.